



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

**PLANI VJETOR PËR KRYERJEN E MBIKËQYRJES
ADMINISTRATIVE NË VITIN 2026**

Në bazë të nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 151, në lidhje me nenin 27, paragrafi (3) dhe neni 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42 /20, 77/21 dhe 154/23), neni 29 të Ligjit për Mediat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13 dhe 13/14) dhe neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 19 dhe neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 15 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1, datë 29.7.2019, dhe në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5193/12 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 24-ët, mbajtur më 25.12.2025, miratoi:

PLAN VJETOR PËR KRYERJEN E MBIKËQYRJES ADMINISTRATIVE NË VITIN 2026

Mbikëqyrje administrative kryhet mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Mediat, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe dispozitat e miratuara në bazë të ligjit. Mbikëqyrje administrative mbi punën e botuesve të mediave të shkruara dhe botuesve të mediave online - portaleve të internetit ekskluzivisht kryhet nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenet 6, 8, 14 dhe 15 të Ligjit për Mediat.

Plani Vjetor për mbikëqyrjen administrative (në tekstin e mëtejme i referuar si Plani Vjetor) miratohet nga Këshilli i Agjencisë me propozim të drejtorit.

Sipas Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbikëqyrja administrative mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese. Plani vjetor i referohet vetëm mbikëqyrjes së rregullt.

Gjatë planifikimit të fushëveprimit të aktiviteteve të mbikëqyrjes së rregullt në këtë Plan Vjetor, u morën parasysh si vijon: detyrimet e Agjencisë që rrjedhin nga Plani Vjetor për mbikëqyrje programore në vitin 2026; aktivitete të tjera të planifikuara në Programin e Punës së Agjencisë; prezumime për mbikëqyrje të jashtëzakonshme që mund të dalin në bazë të ankesave nga persona juridikë ose fizikë ose të kryera sipas detyrës zyrtare nga Agjencia; si dhe faktin se në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Agjencia ka detyrim që pas ç'do shqiptimi të masës, pasi të ketë skaduar afati i përcaktuar në aktin e veçantë për shqiptimin e masës, të kryehet mbikëqyrje kontrolli.

TRANSMETUESIT

Plani vjetor për mbikëqyrjen e rregullt administrative në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga neni 14 i Ligjit për Mediat dhe neni 51 dhe neni 97 i Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale përfshin: shërbimet programore në radio dhe televizion të Shërbimit publik radiodifuziv (RTM), transmetuesit me leje për punë në nivel shtetëror dhe disa nga transmetuesit që emetojnë programe në nivel rajonal dhe lokal.

Mbikëqyrja e rregullt administrative mbi përmbushjen e detyrimeve sipas nenit 15, paragrafët 1, 4 dhe 6 të Ligjit për Mediat dhe detyrimet sipas nenit 62, paragrafi 6 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenet 9 dhe 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio do të përfshijë të gjithë transmetuesit komercialë.

Mbikëqyrje e rregullt administrative

Rishikim i dispozitave ligjore që do jenë objekt i mbikëqyrjes:

Neni 14 (Ligji për Mediat) Impresium

(1) Botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për secilin bartës individual të përmbajtjes (për shembull, kopje të medias së shtypur, emisioni televiziv dhe në pjesën impresium të medias online-portalit të internetit) të siguron publikimin e të dhënave të mëposhtme:

- emri dhe adresa e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias,
- emri i personit përgjegjës të botuesit të medias,
 - emri dhe mbiemri i kryeredaktorit, pra redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe
 - emrin dhe adresën e shtypshkronjës, datën e shtypjes ose të ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur është medium i shtypur.

(2) Për transmetuesit, detyrimi nga paragrafi (1) të këtij neni zbatohet në mënyrë të tillë që të dhënat publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audi vizuale.

(3) Botuesi i mediumit është i detyruar në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje të publikojë informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe mbiemrin e autorit të shkrimit të botuar,
- emri dhe mbiemri i personit, përkatësisht kompaninë që mban të drejtat e autorit të përmbajtjes së publikuar, përveç në mediat e shtypura dhe programet në radio,
- data e produksionit (muaji dhe viti) kur kemi të bëjmë me vepër audio/audi vizuale,
- origjina e veprës audio/audi vizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga produksion i pavarur dhe informacion rreth saj,
- emri i personit juridik, përkatësisht emri dhe mbiemri i personit që ruan pronësinë kulturore të përdorur ose veprën arkivore, përkatësisht riprodhimin përkatës, dhe
- emri i botuesit të mediumit nga i cili është marrë shtojca e programit ose fragment nga shtojca e programit, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rënë dakord ndryshe.

Neni 15 (Ligji për Mediat) Transparenca në punën e botuesve të medias

- (1) Transmetuesit janë të detyruar deri më 31 mars të vitit aktual në formular të veçantë të përcaktuar nga organi rregullator kompetent t'i paraqesin të dhënat mbi:

- strukturën pronësore, përkatësisht të dhënat mbi emrin dhe selinë e personave juridikë ose emrin dhe vendin e banimit të personave fizikë që janë pronarë të aksioneve ose marrin pjesë si botues të medias, me të dhëna mbi përqindjen e aksioneve ose pjesës së fituar dhe datën e blerjes,

- të dhëna rreth kryeredaktorit/redaktorëve,

- të dhëna mbi burimet e financimit të transmetuesit në vitin paraprak (reklama, sponsorizim, shitje përmbytjesh, shërbime të ofruara palëve të treta, etj.),

- të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale të transmetuesit në vitin paraprak nga ofrimi i aktivitetit dhe

- të dhëna mbi shikueshmërinë ose dëgjueshmërinë mesatare të transmetuesit në vitin e kaluar.

(2) Botuesit e mediave të shkruara janë të detyruar të dhënat nga paragrafi (1), nënparagrafi 1 të këtij neni t'i publikojnë së paku në një gazetë ditore, një herë në vit, deri më 31 mars të vitit aktual, dhe fragment nga publikimi t'ia dorëzojnë organit rregullator kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

(3) Botuesit e mediave online - portaleve të internetit janë të detyruar deri më 31 mars të vitit aktual në formular të veçantë të përcaktuar nga organi rregullator kompetent të paraqesin të dhëna mbi:

- strukturën pronësore, përkatësisht të dhënat mbi emrin dhe selinë e personave juridikë ose emrin dhe vendin e banimit të personave fizikë që janë pronarë të aksioneve ose që marrin pjesë si botues të medias, me të dhëna mbi përqindjen e aksioneve ose pjesës së fituar dhe datën e blerjes,

- të dhëna rreth kryeredaktorit/redaktorëve,

- të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara të botuesve të mediave online - portaleve të internetit në vitin paraprak nga ofrimi i aktivitetit dhe

- të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të të punësuarve përkatësisht të personave të punësuar.

(4) Radiotelevizorët janë të detyruar të dhënat nga paragrafi (1) nënparagrafët 1,2 dhe 3 të këtij neni t'i publikojnë në programin e tyre, së paku tre herë në vit, gjatë kohës së shikueshmërisë kryesore, dhe t'ia dorëzojnë regjistrimin e publikimit organit rregullator kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit sipas mënyrës së përcaktuar nga organi rregullator kompetent.

(5) Formularët nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni publikohen në ueb-faqen e organit rregullator kompetent.

(6) Transmetuesit janë të detyruar t'i paraqesin raport me shkrim organit rregullator kompetent mbi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv dhe radio, dhe në veçanti mbi zbatimin e konceptit programor, deri më 31 mars të vitit aktual. Si shtojcë e raportit duhet të dorëzohet dhe informacion mbi mjetet teknike përmes të cilës transmetohet ose ritransmetohet shërbimi i tyre programor në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë saj. Raporti me shkrim duhet të dorëzohet në formular të përcaktuar nga organi rregullator kompetent.

(7) Organi rregullator kompetent duhet ta paralajmëron me shkrim botuesin e medias që nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në këtë nen dhe duhet t'i japë një afat shtesë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 45 ditë, brenda të cilit botuesi i medias është i detyruar të përmbushë detyrimet e parashikuara të këtij neni. Nëse botuesi i medias nuk i përmbush detyrimet e parashikuara të këtij neni brenda afatit shtesë, organi rregullator kompetent duhet t'i marrë lejen për transmetim televiziv ose radio në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

(8) Botuesi i medias së shtypit është i detyruar t'i sigurojë Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut një kopje të çdo numri të botuar të medias së shtypur, pa pagesë.

(9) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për shërbimin publik radiodifuziv.

Neni 51 (Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale) Informacion i disponueshëm për përdoruesit

(1) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat në vijim:

- emri i ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel, përkatësisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar identifikuese (avizo, logo, dhe të ngjajshme),

- adresën e selisë qendrore të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel,

- të dhënat për kontakt të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel (numër telefoni, e-mail adresën dhe/ose ueb-faqes, person për kontaktit të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe

- nëse është e mundur të dhëna edhe për organin rregullator kompetent.

(2) Shenjat e identifikimit duhet të shfaqen vazhdimisht në të gjitha programet, përkatësisht të transmetohen së paku një herë gjatë një ore reale në programin e radios.

(3) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale mund të përdorin vetëm shenjat e tyre të identifikimit.

(4) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale janë të detyruar për çdo ndryshim të shenjave për identifikimin e tyre të paraqesin kopje në Agjencion.

**Neni 97 (Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale)
Identifikimi i transmetuesit**

- (1) Transmetues duhet të ketë shenjë të tyre identifikuese.
- (2) Shenja identifikuese e transmetuesit duhet të shfaqet vazhdimisht gjatë kohës së transmetimit të programit televiziv, përkatësisht të transmetohet së paku një herë gjatë një ore reale të programit në radio.
- (3) Në rastet kur transmetues emeton program në një sistem të vetëm, gjatë kohëzgjatjes së programit, gjithashtu është i detyruar të shfaqë shenjat e identifikimit.
- (4) Transmetues nuk mund të përdorë shenjë identifikimi tjetër përveç shenjës së përcaktuar në lejen për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive.
- (5) Për çdo ndryshim të shenjës identifikuese, transmetuesi është i detyruar t'i paraqesë Agjencisë një kopje të saj.

**Neni 62 paragrafi 6 (Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale)
Kushtet për ofrimin e transmetimit televiziv dhe radio**

Për të ofruar transmetim televiziv ose radio, përveç kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë Ligj, transmetuesi duhet të përmbushë kushte të veçanta minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice në varësi të formatit programor të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Agjencia.

**Neni 9 (Rregullore për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio)
Numri dhe struktura e të punësuarve**

Poseduesi i lejes për transmetim në radio është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune të ketë së paku:

- 1) 10 (dhjetë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim në radio folëse ose folëse-muzikore në nivel shtetëror;
- 2) 7 (shtatë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim në radio folëse ose folëse-muzikore në nivel shtetëror;
- 3) 4 (katër) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim në radio folëse ose folëse-muzikore në nivel rajonal;
- 4) 3 (tre) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim në radio folëse ose folëse-muzikore në nivel rajonal;
- 5) 2 (dy) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel lokal, për zonë me mbi 50,000 banorë;
- 6) 1 (një) person që merr pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel lokal, për zonë me nën 50,000 banorë.

Kryeredaktori i shërbimit programor duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Personat e përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë të punësuar te transmetuesi me orar të plotë pune, në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune.

Personat që marrin pjesë në krijimin e programit janë gazetarë, moderator, teknikë të pajisjeve për regjistrim dhe transmetim të zërit, montazhierë, si dhe persona të punësuar në vende të tjera pune që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e programit.

Përmbushja e kushteve minimale kuadrovice dëshmohet duke dorëzuar dokument për Regjistrim/Çregjistrim në sigurimin shoqëror të detyrueshëm - Formulari M1/M2 i dhënë nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Neni 21 (Rregullore për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio)
Numri dhe struktura e të punësuarve**

Poseduesi i lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm është i detyruar që në marrëdhënie të rregullt pune, të ketë së paku:

- 1) 70 (shtatëdhjetë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel shtetëror nëpërmjet transmetuesi tokësor;
- 2) 20 (njëzet) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel shtetëror nëpërmjet rrjeti publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuara ose nëpërmjet sateliti;

- 3) 7 (shtatë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në rajonin D1-Shkup;
- 4) 5 (pesë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në rajonet: D1-Crn Vrv - Veles, D2-Strashin, D3-Turtel, D4-Boskija, D5-Pelister, D6-Mali Vllaj dhe D8-Kodra e Diellit;
- 5) 3 (tre) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në rajonin D7-Stogovë;
- 6) 4 (katër) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel lokal, për zonë me mbi 50,000 banorë;
- 7) 3 (tre) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel lokal, për zonë prej 30,000 deri në 50,000 banorë;
- 8) 2 (dy) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel lokal, për zonë me nën 30,000 banorë.

Poseduesi i lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të specializuar është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune të ketë së paku:

- 1) 10 (dhjetë) persona nëse ka leje për transmetim të programit në nivel shtetëror;
- 2) 3 (tre) persona nëse ka leje për transmetim të programit në nivel rajonal;
- 3) 1 (një) person nëse ka leje për transmetim të programit në nivel lokal.

Kryeredaktori i shërbimit programor, dhe i formatit të përgjithshëm dhe të specializuar, duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Personat e përmendur në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni duhet të jenë të punësuar te transmetuesi me orar të plotë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhënie Pune.

Personat që marrin pjesë në krijimin e programit janë gazetarë, moderator, teknikë të pajisjeve për regjistrimin dhe transmetimin e imazheve dhe zërit, kameramanë, montazhierë, si dhe persona të punësuar në vende të tjera pune që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e programit.

Përmbushja e kushteve minimale kuadrore vërtetohet duke paraqitur dokument për Regjistrim/Çregjistrim në Sigurimin shoqëror të detyrueshëm - Formulari M1/M2 të dhënë nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Plani i mbikëqyrjes – llojet e transmetuesve dhe periudha e realizimit:

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimeve sipas neneve 14 të Ligjit për Mediat dhe nenet 51 dhe 97 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale** do të kryhet mbi:

- Shërbimet kombëtare të programeve televizive komerciale që transmetohen përmes ORRPKE -
në mars të vitit 2026;
- Shërbimet e programit televiziv komercial satelitor kombëtar –
në mars të vitit 2026;
- Shërbimet e programit televiziv komercial tokësor kombëtar –
në maj 2026;
- Shërbimet e programit televiziv të Shërbimit Publik Radiodifuziv -
në qershor 2026;
- Shërbimet e programeve në radio të Shërbimit Publik Radiodifuziv –
në qershor 2026;
- Shërbimet e programit në radiot komerciale kombëtare–
në korrik 2026;
- Shërbimet programore televizive komerciale rajonale – zgjedhje prej 6
në qusht 2026;

- Shërbimet programore televizive komerciale lokale – zgjedhje prej 6

në shtator 2026;

- Shërbimet programore në radiot komerciale rajonale – zgjedhje prej 6

në tetor 2026;

- Shërbimet programore në radiot komerciale lokale – zgjedhje prej 6

në nëntor 2026;

- Shërbimet programore në radiot fofitimprurëse -

në dhjetor 2026.

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimeve të nenit 15, paragrafi 6 i Ligjit për mediat** (raporti me shkrim mbi zbatimin e konceptit programor dhe për kushtet e lejes) kryhet mbi të gjithë transmetuesit komercial në bazë të të dhënave që janë të detyruar t'i paraqesin deri më 31 marsi të vitit aktual, dhe të cilat i referohen vitit kalendarik të mëparshëm.

- Të gjithë transmetuesit komercialë –

në prill të vitit 2026.

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimit të nenit 15, paragrafi 1 të Ligjit për Mediat** do të kryhet mbi:

- Të gjithë transmetuesit komercialë –

në prill të vitit 2026.

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimit të nenit 15, paragrafi 4 të Ligjit për Mediat** do të kryhet mbi:

- Të gjithë transmetuesit komercialë –

në prill, korrik dhe nëntor të vitit 2026.

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimeve të nenit 62, paragrafi 6 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenit 9 dhe 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio** do të kryhet mbi të gjithë televizionet komerciale, një herë gjatë vitit.

BOTUES I MEDIAS SË SHTYPIT

Mbikëqyrja administrative mbi botuesit e medias së shtypit do të përfshijë detyrimet që dalin nga neni 14 paragrafi (1) dhe neni 15 paragrafi (2) të Ligjit për Mediat.

Plani i mbikëqyrjes – botuesit e medias së shtypit dhe periudha e realizimit:

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimit të nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit për Mediat** do të kryhet mbi:

- Të gjithë botuesit e medias së shtypit –

në shkurt, qershor dhe tetor të vitit 2026.

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimit të nenit 15, paragrafi 2 të Ligjit për Mediat** do të kryhet mbi:

- Të gjithë botuesit e medias së shtypit –

në prill të vitit 2026.

BOTUES TË MEDIAS ONLINE – INTERNET PORTALET

Mbikëqyrja administrative mbi botuesit e mediave online – internet portaleve do të përfshijë detyrimet që dalin nga neni 14 paragrafi (1) dhe neni 15 paragrafi (3) të Ligjit për Mediat.

Plani i mbikëqyrjes – botuesit e mediave online – internet portaleve dhe periudha e realizimit:

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimit të nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për Mediat** do të kryhet mbi:

- Të gjithë botuesit e mediave online – internet portaleve –
në shkurt, korrik dhe nëntor të vitit 2026.

Mbikëqyrje e rregullt administrative **për respektimin e detyrimit të nenit 15 paragrafi 3 të Ligjit për Mediat** do të kryhet mbi:

- Të gjithë botuesit e mediave online – internet portaleve –
në prill të vitit 2026.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski